




**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL II/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 2 (dytë) për vitin 2022 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

**Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 28.02.2022
Ora: 10.00**

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci	Znj.Mevlude Kabashi	Të pranishëm të tjerë
Z.Selman Kolgeci	Znj.Sheqerije Zyrapi	Kryetari Komunës
Z. Flamur Bytyqi	Znj.Laureta Tafaj	Media dhe qytetarë
Z. Urim Suka	Z.Liridon Fandaj	OSCE, LMT, KDI
Z. Kushtrim Kuçi	Z.Qëndrim Elshani	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Elmaze Bytyqi	Znj.Festë Kabashi	Z.Xheladin Sadikaj
Znj. Bulëza Kuçi	Z.Herolind Limaj	
Znj.Doruntina Zenelaj	Znj. Jehona Rrafshi	
Z.Alban Berisha		
Z. Bexhet Kuçi		
Z. Reshat Selimaj		
Z. Lirim Qatani		
Z. Aziz Bytyqi		
Znj.Sanie Kuçi-Rexhepaj		
Znj.Besa Kuçi		
Znj.Fidaije Kukaj		
Znj. Afërdita Morina		
Z. Enver Shabani		
Z. Driton Maliqaj		
Z. Xhevxhet Gashi		
Z.Edon Sadikaj		
Z.Dardan Berisha		
Z.Bajram Basha		

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi .

Rend dite

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjeksisë Familjare në Suharekë;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës të punëtorëve të Administratës së Komunës;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të realizuara në vitin 2020 dhe vitin 2021 për shfrytëzim në vitin 2022;**
5. **Shqyrtim i projekt-vendimt për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursa;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për pronë;**
7. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, "Eko-Regjioni" Sh.A;**
8. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave;**
9. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**
10. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-61754;**
11. **Njoftimi i planit të prokurimit për vitin 2022;**
12. **Raporti i punës për zyrën e prokurimit për vitin 2021;**
13. **Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit, i njofton me rendin e ditës dhe e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - a keni vërejtje në procesverbal?

Laureta Tafaj - ka mangësi në procesverbal.P.sh. Qëndrimi ka dal tre here në votim për një komision dhe nuk është shkru,është shkru vetëm votimi i fundit.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Miratohet me vërejtje

Pika 2. .Shqyrtimi i projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjeksisë Familjare në Suharekë;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe ia jep fjalën zyrëtarit ligjor.

Avni Bytyqi - me vendim të Kryetarit është formu grupi i punës për hartimin e draft-satutit të QKMF-së,që është kërkesë e drejtorisë së shëndetësisë.Ai si kryesues i këtij grupi punues elaboron më gjerësisht hartimin e këtij draft-statuti dhe thotë se si grup punues kemi arrit në përfundim që ta hartojmë këtë status dhe ta harmonizojmë me ligjet dhe aktet nënligjore.

Kryesuesi - hap debatin.

Urim Suka - kush ka qenë pjesë e grupit punues?

Avni Bytyqi - rregullorja e miratuar nga qeveria i jep kompetencë dhe mandat Kryetarit të Komunës që të formon grupe punuese për hartimin e akteve nënligjore. Kryesuesi i grupit kam qenë unë, ndërsa anëtar të komisionit ka qenë drejtoresha Sale Bytyqi dhe Dr. Betim Iballi.

Laureta Tafaj - ju përgëzoj. Që sa kohë keni fillu me punu dhe a ka pas deri më tash zëvendës drejtor, apo kjo rregullore është bo për me bo një zëvendës drejtor në QKMF?

Avni Bytyqi - ne kemi punu dy muaj vazhdimisht. Sa i përket zëvendës drejtorit nuk e kemi shpikur këtë pozitë por e kemi harmonizuar sipas udhëzimit administrative, ku parashihet që të gjitha QKMF-të në nivel të Kosovës, që kanë të punësuar mbi 100 punëtor mund të përzgjedhin zëvendës drejtor.

Laureta Tafaj - pyetja ishte, a ka pas deri më tash.

Avni Bytyqi - jep sqarime dhe thotë se nuk ka pas deri tani.

Elmaze Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Ne si grup parlamentar i LDK-së kërkojmë sqarime nga hartuesit e këtij statusi. Pse nuk është përfshi njesia e maternitetit te neni 10 - Organizimi i QKMF-së, ka qenë në të kaluarën.

Avni Bytyqi - besoj në kuadër të statutit është si shërbim.

Elmaze Bytyqi - në të kaluarën ka qenë si njesi dhe tjetër është si shërbim.

Avni Bytyqi - te neni 7 paragrafi 6 e parasheh: në QKMF ku funksionon materniteti është i domosdoshëm gjinekologu, neurologu dhe pediatri. Këtë e ka përshkruar udhëzimi administrative dhe ne jashtë udhëzimit nuk mund të dalim. Në kuadër të shërbimit, ky shërbim ekziston.

Dardan Berisha - ne si gr. Parlamentar i PDK-së i besojmë këtij komisioni dhe e mbështesim.

Shefket Kolgeci - statuti i vjetër e ka pas njesi të vetme. Pse u ndërru, prej njesisë u bë shërbim?

Avni Bytyqi - unë e sqarova më herët. Ai jep sqarime edhe një herë si zyrtar ligjor.

Alban Berisha - përgëzon grupin punues. Dokumente të tilla ne obligohemi mi nxjerr dhe me bo plotësim ndryshim ashtu si kërkohet me ligj. Vërejtja është: oragani që e nxjerr një dokument është Asambleja, dhe për mua është jo e drejtë që me na ardh afati final, pro apo kundër. Ne si opozitë gjithmonë i kemi votu këto akte kur janë në përpuethshmëri me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Nuk është urgjente. Një seance paraprake duhet me ardh për shqyrtim ose me i njoftu shefat e grupeve parlamentare, dhe jo me ardhë faza përfundimtare.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**30 për, 1 kundër,
Miratohet pika 2**

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës të punëtorëve të Administratës së Komunës;

Kryesuesi - kjo pikë ka të bëjë me kërkesën e punëtorëve të administratës së Komunës. Ka qenë edhe vitin e kaluar, por është kthyer nga ministria për shkak të mos planifikimit të buxhetit dhe ka ardh prap si kërkesë. Ata kërkojnë që shujta të jetë 3.5 euro. Duhet ta gjejmë një mesazh, dhe mendimi im është të paguhet me 3 euro. Hap debatin për këtë pikë.

Laureta Tafaj - a është mendim vetëm i juaji, apo unik i grupit?

Kryesuesi - unë po e jap si sugjerim personal.

Aziz Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Sa i përket kërkesës, një vendim i tillë ka ekzistuar që nga qershori i viti 2021, por mjetet buxhetore janë nda në 2.5 euro. Duke pas parasysh implikimet buxhetore, në emër të grupit propozoj që shujta të jetë 3 euro.

Dardan Berisha - nëse i referohemi kësaj shume, unë mendoj që shujta prej 3 eurove, si janë shërbimet në restorante është e mjaftueshme.

Urim Suka - në emër të grupit parlamentar e mbështesim ashtu si është kërku nga ta. Në KPF kam kërku nga ju, se si po mendoni me implemtu këtë kërkesë, dhe si ekzekutiv nuk e keni dhënë idenë konkrete. Shihet në tendencë që ky pushtet ka, që këto mjete të kalohen përmes në procedurë të prokurimit dhe ti jepet një kompanie ndoshta, dhe punëtorët detyrohen me u ushqy me në vend.

Kërkoj që ta merrni këtë kërkesë më seriozisht, të gjeni rrugët ligjore që këto mjete me iu dal si page.

Festë Kabashi - ne si grup parlamentar do ta votonim këtë projekt-vendim por me një propozim konkret. Mendojmë që pagesa e shujtës ditore për punëtorët e administratës duhet të jetë e barabartë me pagesën që u ipet punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë. Përndryshe shifra e propozuar 3.5 euro, do të diskriminonte arsimin dhe shëndetësinë. Na inetereson të dijmë se prej cilës vijë buxhetore do të ndahen këto para.

Selman Kolgeci - përshëndet të pranishmit. Mendoj që është e arsyeshme kërkesa e punëtorëve të administratës, por nuk e kam të qartë se në çfarë forme do të subvencionohen. Poashtu mendoj që edhe punëtorëve të arsimit ti mbulohen shpenzimet e shujtave, për faktin që del obligim nga kontrata kolektive. Buxhetit të Komunës sonë, përmes

procedurave gjyqësore po i kushtojnë qindra euro shpenzime që mësimdhënësit po i tërhekin duke paditur Komunën. Përpos obligimit nga kontrata kolektive për punëtorët e arsimit, mendoj që duhet edhe të stimulohen që të punojnë më shumë, për faktin që z. Muharremaj politikat tuaja të gabuara kanë degraduar arsimin në Suharekë.

Shefket Kolgeci - i mbështes parafolësit e mi. Unë propozoj që kjo shumë të mbetet 3.5 euro, shkaku se punëtorët e Komunës me paga janë dobët dhe është një formë stimuluese për ta. Dhe forma e pagesës do të ishte mire t'ju hidhet në konto.

Laureta Tafaj - po e zëmë miratohet me 3.5 euro, dhe mbas një kohe vje nga shëndetësia dhe arsimit që me pas edhe ata 3.5 euro. A e bini këtë vendim me shfuqizim prap dhe mi lan as ata, as ata.

Avni Bytyqi - Qështja punëtorëve të shëndetësisë dhe arsimit qështjen e shujtës e kanë të rregulluar me kontratë kolektive. Andaj ne jemi të obliguar ti zbatojmë dhe ne nuk mundemi ti ikim asaj marrëveshje dhe ta bim në Asamble dhe ta rrisim vlerën. Sa i përket punëtorëve të administratës, një qështje të tillë nuk e kanë të rregulluar me kontratë kolektive të përgjithshme, dhe kjo ka mbetë kompetencë e Komunës dhe Kuvendit.

Fadil Hoxha - përshëndet të pranishmit. Herën e kaluar kemi bo planifikimin me 2.5 euro dhe ky 1 euro që është shtuar, është e lartë për buxhetin tonë. Sipas kalkulimeve që kemi bo, na kushtom 117 370 euro. Secila drejtori i ka të planifikura në bazë të nr. të punëtorëve. Ligji i prokurimit nuk na lejon me bo kontratë me Benaf apo Elkos, por s' do të thotë që s' mundemi me ekzekutu. Për secilin punëtor duhet me bo kërkesë veq e veq me regjistru në thesar.

Flamur Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Pse po insistoni me shti këtë pagesë, me rëndu buxhetin? Pse se merrni parasysh kontratën kolektive për punëtorët e arsimit, a po pritni që prap Komunës mi shkaku humbje me padi puëtorët e arsimit për shujta? Në parim jam për punëtorët e administratës, por pse me kaq nxitim?

Fadil Hoxha - te punëtorët e shëndetësisë dhe arsimit, nuk është obligim i Komunës, sepse ato janë marrëveshje mes sindikatave dhe ministrisë së linjave. Realisht te shëndetësia janë të planifikume në buxhet dhe nuk ka problem.

Flamur Bytyqi - ka Komuna që kanë planifiku me kohë. Psh. Skënderaji.

Avni Bytyqi - sindikata e punëtorëve e kanë bo këtë kërkesë për vlerën 3.5 euro, për arsye të rritjes së çmimeve.

Kryesuesi - kemi tri kërkesa. AAK dhe PDK kërkojnë që të jetë 3 euro, LDK kërkon të jetë 3.5 euro dhe VV sëbashku me listën Guxo elaboruan që shujta të jetë e barabartë me të arsimit dhe të shëndetësisë.

Festë Kabashi - ne nuk e patëm të qartë mënyrën se si funksionon ligjërisht, dhe i pranum komentet e zyrtarit ligjor. Ne jemi pro vendimit, qoftë edhe 3.5.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin me 3 euro.

18 për

Kryesuesi - e hedh në votimin propozimin me 3.5 euro.

13 për

Miratohet pika 3, me propozimin 3 euro

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të realizuara në vitin 2020 dhe vitin 2021 për shfrytëzim në vitin 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - diskutimin e kësaj pike do e filloj me fjalët e Kryetarit Muharremaj të thëna në kohën e fushatës në vitin 2017, ku thoshte: në qeverisjen e LDK-së gjatë viteve 2015-2016 janë bartur nga 300 mijë euro. Kryetari i Komunës në bashkëpunim me stafin politikë dhe Asamblenë duhet me hargju deri në fund të vitit.

Andaj sot për vitin 2020-2021 për vitin 2022 dua të përcjell dy mesazhe. Dua ti bëj me dije secilit qytetar që ky Kryetar që sot ka sjell këtë projekt-vendim për bartjen e rreth 1 milion eurove, disa vite më pare bënte zhurmuesin e kritikave. I drejtohem secilit qytetar se Kryetari Muharremaj ka fillu të bartë, jo nga 300 mijë por nga 1 milion euro. Kjo është keqmenaxhim i parasë publike.

I keni nda 12156 euro për punimin e ujësjellësit në Peqn, Bllacë Papaz, Grejkoc. 12 mijë nuk mjaftojnë për një familje për ta siguru ujin. Ka plot shembuj që ky planifikim nuk i mbron interesat e qytetarëve. Andaj ne jemi kundër dhe do e ngrisim zërin për secilin vendim që është në kundërshtim me interesat e qytetarëve.

Qëndrim Elshani - Kryetar, ti gjithmonë je thirr në mire menaxhim të buxhetit të Komunës, e tash kësaj here kanë tepu kogja do pare.

-Te shërbimet publike dhe emergjenca, kanë tepu 270 mijë euro. A nuk ke pas projekte, apo i ke përfundu projektet në vitin e kaluar pa tender e tash po do me i bartë në vitin 2022 për mi mbulu pa tender. -Te bujqësia dhe zhvillimi rural kanë mbetur rreth 85 mijë euro. A s'ka pas kërkesa nga fermerët për subvencionim, duke marrë parasysh që kemi pas një vit pandemik ku bujqit kanë pas nevojë për subvencionim. -Te shërbimi i kujdesit primar shëndetësor ku mjetet në vlerë 25 mijë euro kanë që të dedikune për blerjen e paisjeve shëndetësore. A nuk kanë qenë të

nevojshme këto paisje apo ka pas diçka që nuk shkon me tender? - E njehta ka vazhdu edhe në shërbimet kulturore,rini dhe sport ku ka vlerën rreth 70 mijë euro,te urbanizmi dhe planifikimi urban me vlerën rreth 86 mijë euro dhe te administrate e arsimit rreth 93 mijë euro.

Selman Kolgeci - z Muharremaj nuk keni arritur as gjysmën e mjeteve të planifikuara nga ky burim i të hyrave ti investoni gjatë vitit 2021.Çfarë ju ka penguar ti investoni? Për të qenë realist jam në dijeni që mund të mbetet një vlerë e vogël pa shpenzuar,por diferenca kaq e madhe është tregues i një performance të dobët të qeverisë.- Edhe pse keni investuar në rrugë private e oborre private jasht planifikimit buxhetor,prap nuk keni arritur ti shpenzoni,e kjo quhet keqpërdorim i parasë,ndërsa mos shpenzimi i mjeteve sipas palnifikimit quhet keqmenaxhim i parasë publike.Vepimi denohet nga organet e drejtësisë,ndërsa politikanët e guximshëm e realist ia dorëzojnë mandatin sovranit për shkak të dështimit.

Driton Maliqaj - përshëndet të pranishmit.Sa i përket mandatit për me dorzu sovranin,sovrani e vendosi për menaxhimin e mire apo jo të mire të Kryetarit të Komunës. Sa i përket shpenzimeve të buxhetit,ka qenë e vërtetë se janë thirrë qytetarët për mos menaxhim të mire në vitin 2014-2015 në kohën e ish Kryetarit të kaluar. Mirëpo për me qenë realist duhet të bëni kategorizimin e mjeteve të kthyer,d.m.th ,a janë grande buxhetore dhe a po kthehen suficit,apo janë 2021-2022-shit.Nëse janë '21-'22,këto pare nuk humbin,por kthehen për vitin e ardhshëm dhe prap shfrytëzohen për Komunën e Suharekës. - Për 4 vite mandate të Kryetarit Muharremaj kemi pas super buxhet nga donator të ndryshëm,nga organe qeveritare,që për 18 vite pushtet nuk do i kishit hargju.

Urim Suka - unë i fjalët e Kryetarit Muharremaj dhe asgjë nuk shtova.Ju keni kritikua atëherë pse i kemi bartë 300 mijë euro,dhe ju sot keni pru një vendim për mi bartë 923 mijë euro.

Qëndrim Elshani - desha ti kundërpërgjigjem kolegut nga AAK-ja.Na akuzojë se po manipulojmë,mirëpo dallon shumë manipulimi dhe informimi drejt qytetarit.

Fadil Hoxha - si zyrëtar financiar jep sqarime rreth kësaj pike,ku thotë:buxheti Komunal për vitin 2021 ka qenë 16,000,334.00.Prej këtyre janë shpenzu 16,922,000.00 mijë.Prej totalit të përgjithshëm të hyrat vetanake janë realizu më tepër se sa kanë qenë të planifikuara. Me udhëzimin administartiv për përfundimin e vitit fiskal projektet kapitale zbatohen deri më 31 tetor.Pas 31 tetorit çfarëdo mjeti që vje në llogarinë e Komunës,nuk mund të përdoren.

Urim Suka - mos po thoni që data 31 tetor është kur keni ardhë në pushtet.Edhe atëherë ka qenë ajo datë.

Kryetari - unë pajtohem me asambleistin,por nuk kam thënë 300 mijë,por 1.1 milion.

Për katër vite janë investu mbi 40 milion euro dhe 10 milion donacione.Kanë mbet pa u shpenzu 170 mijë euro,të tjerat janë shpenzu.Qytetarë kanë dëshiru me i pagu obligimet dhe janë mbledhë para më shumë. - Janë planifiku nga 100 mijë euro për shtëpinë muze "Fadil Vata" dhe për Kullën e Dëshmorëve,mirëpo janë shpenzu vetëm nga 70 mijë euro.Pra ato mjete barten dhe nuk shkojnë suficit. Kryetari vazhdon më tej me përgjigje tjera.

Urim Suka - ne jemi mësu me Kryetarin me këto përgjigje.Unë e kam videon në facebook ku e keni thënë.Dhe unë nuk fola për suficit por për bartje.Suficitin do ta përmendim në mars.

Flamur Bytyqi - te drejtoria e inspeksionit janë planifikuar 10 mijë euro,dhe nuk është shpenzu asnjë cent.Cila është arsyeja,pse nuk po shpenzohen këto mjete duke e ditë gjendjen?

Kryetari - aty ku ka ps nevojë ne i kemi shpenzu dhe ju e dini.

Flamur Bytyqi - por nuk është shpenzu asnjë cent.

Kryetari - ato që kanë qenë grande janë shpenzu.Këto janë të hyra vetanake dhe barten.

Kryesuesi - e hedh në votim.

18 për,11 kundër, 2 apstenime
Miratohet Pika 4

Pika 5.Shqyrtim i projekt-vendimt për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursa;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë,dhe thotë se komisioni do ti ketë 5 anëtar dhe të gjithë do jenë nga Kuvendi.Kërkon propozimet nga partitë politike.

Driton Maliqaj - gr. parlamentar i AAK-së propozon Mimoza Bajraktari dhe Aziz Bytyqi .

Laureta Tafaj - a i takojnë dy propozime subjektit? Kërkoj sqarim.

Avni Bytyqi - jep sqarime.

Elmaze Bytyqi - gr. parlamentar i LDK-së propozon Kushtrim Kuçi.

Dardan Berisha - gr. parlamentar i PDK-së propozon Sheqerije Zyrapi.

Laureta Tafaj - gr.parlamentar i VV-së së bashku me listën Guxo propozon Qëndrim Elshani.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5 me propozimet që u dhanë.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për pronë;

Kryesuesi - edhe ky komision parashihet ti ketë pesë anëtar.Dy janë nga Kuvendi,dy nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile.

Aziz Bytyqi - gr. parlamentar i AAK-së propozon Liridon Sadikaj dhe Saranda Bajraktari.

Shefket Kolgeci - gr. parlamentar i LDK-së propozon Kushtrim Kuçi.

Kryesuesi - nga ekzekutivi është propozuar Labinot Halitjaha dhe Kimete Bajraktari.Ndërsa nga sektori joqeveritar është propozuar Ismet Gashi.

Urim Suka - ju i propozuat dy ,por ligji e thotë që duhet të subjekteve të ndryshme.

Festë Kabashi - edhe ne si subjekt politikë propozojmë Laureta Tafaj.

Dardan Berisha - nuk kemi propozim.

Urim Suka - me udhëzim administrative,ligji e thotë që duhet të jenë nga dy subjekte të ndryshme.Respektone ligjin.

Flamur Bytyqi - kërkon sqarim nga zyrtari ligjor.

Avni Bytyqi - është e saktë ajo që thotë Urimi.Komisioni i pronave ka qenë i subjekte të ndryshme ,dhe te komisioni i ankesave prap duhet të jetë nga subjekte të ndryshme politike.Dy nga Kuvendi ndërsa nga ekzekutivi është me kompetencë dhe mandat të Kryetarit.

Aziz Bytyqi - i besoj sqarimit të z.Bytyqi,andaj e tërheqim propozimin për Saranda Bajraktarin.

Dardan Berisha - në këtë rast edhe ne e kemi një propozim,dhe është Sheqerije Zyrapi.

Laureta Tafaj - unë tërhiqem nga propozimi.

Kryesuesi - e hedh në votim anëtarin e propozuar Edon Sadikaj.

20 për, 10 kundër

Kryesuesi - e hedh në votim anëtarin e propozuar Sheqerije Zyrapi.

16 për, 12 kundër

Kryesuesi - e hedh në votim anëtarin e propozuar Kushtrim Kuçi.

13 për, 15 kundër , 2 apstenime

Urim Suka - dola dhe ju tregova për bazën ligjore që jeni gabim.Shefi jua dhe zyrtari ligjor e pranoi që është gabim.Në anën tjetër ju i përdorët numrat me ndihmën e PDK-së,por ligji prap nuk po zbatohet.

Bulëza Kuçi - pas mbylljes së propozimeve,a ka të drejtë me propozu dikush tjetër?kërkon sqarim nga zyrtari ligjor.

Avni Bytyqi - deri sa nuk merret vendim mundet me pas ndryshime.

Kryesuesi - lexon emrat e propozuar: Edon Sadikaj,Sheqerije Zyrapi,Labinot Halitjaha,Kimete Bajraktari dhe Ismet Gashi.Kryesuesi i hedh në votim si pako.

18 për, 12 kundër

Miratohet

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale,"Eko-Regjioni"Sh.A;

Kryesuesi - elaboron këtë pikë dhe thotë që komisioni do të jetë prej tre anëtarëve,ku dy propozohen nga Kuvendi kurse një është propozim i Kryetarit.Kryesuesi kërkon propozimet.

Aziz Bytyqi - gr. parlamentar i AAK-së propozon Sanie Kuçi Rexhepaj.

Elmaze Bytyqi - gr. parlamentar i LDK-së propozon Shefket Kolgecin.

Dardan Berisha - ne nuk kemi propozim por kësaj radhe do ta përkrahim Shefket Kolgecin.

Kryesuesi - i propozuari i Kryetarit është Herolind Limaj.

Qëndrim Elshani - ne nuk kemi propozim por e përkrahim propozimin e LDK-së.

Kryesuesi - i hedh në votim emrat e propozuar si pako.

Unanimisht Miratohet

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave;

Kryesuesi - elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Urim Suka - Ajo që na shqetëson është,që po dyshojmë që ju keni ni tendencë që ta bëni komisionin sipas interesave tuaja.Dy prej propozimeve që vin nga DKA janë pak a shumë specifike,ku njëri prej propozimeve duhet të jetë nga këshilli i prindërve.Në KPF kërkuam sqarime për zgjedhjen e përfaqësuesit të prindërve dhe ju thatë që jeni konsultu me këshillin e prindërve.Kam pas ni takim me kryetarin e këshillit të prindërve dhe ai nuk ish në dijeni fare.Do të ishte mire me ja bashkangjit këtij materiali edhe një shkresë,që këshilli i prindërve e ka propozu atë kandidat.Nëse kjo shkon në këtë formë ne do të apstenojmë.

Kryesuesi - ky komision ka mandatin për një vitë dhe këtë komision e përbën Agim Rraqi-përfaqësues - DKA-së, Arta Hoti-përfaqësuese e këshillit të prindërve,anëtari i tretë caktohet nga ministria,dy përfaqësues të këshilli drejtues të institucioneve edukativo-arsimore në cilësinë e vëzhguesit.

Urim Suka - a mundet dikush prej DKA-së me na sqaru pse s e kanë propozimin e prindërve?

Kryesuesi - nuk është i pranishëm drejtori.

Flamur Bytyqi - a mundemi me pa procesverbalin e këshillit të prindërve për me pa këtë emër si ka ardhë?

Kryesuesi - e hedh në votim.

7 për, 2 kundër, 10 apstenime
Miratohet pika 8.

Pika 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që komisioni do ti ketë 5 anëtarë.Dy do të jenë nga ekzekutivi dhe tre nga Kuvendi.Kryesuesi kërkon propozimet.

Bulëza Kuçi - LDK propozon Shefket Kolgecin.

Aziz Bytyqi - AAK propozon Sanie Kuçi Rexhepaj.

Qëndrim Elshani - LVV propozon Festë Kabashin.

Kryesuesi - të propozuarit janë Shefket Kolgeci,Sanie Kuçi Rexhepaj,Festë Kabashi,Visar Kuçi dhe Armend Krasniqi. I hedh në votim si pako propozimet.

Unanimisht Miratohet

Pika 10.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-61754

Kryesuesi - e elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Sheqerije Zyrapi - kërkoj që ky shfuqizim i vendimit të bëhet pjesërisht.Pra, mos të shfuqizohet për rastet sociale dhe skemat pensionale.

Urim Suka - ky pushtet pa analizuar e planifikuar pasojat,mori vendim për subvencionimin ndaj të prekurve me Kovid 19,sepse zgjedhjet ishin në prag dhe duhej të krijonte politika me qëllim të përfitimit elektoral.Ndërsa sot ky synim është arritur dhe na sjellini shfuqizimin e vendimit paraprak.Këto vendime të tilla krijojnë padrejtësi dhe trajtim jo të barabartë për qytetarët e Komunës së Suharekës.Me shfuqizimin e tij qytetarët tjerë nuk do të mund të subvencionohen. Ne jemi kundër një vendimi të tillë dhe bëjmë thirrje që sa më pare ta ndryshoni dhe të reflektoni

Selman Kolgeci - ky projekt-vendim po i penalizon edhe ata qytetarë të cilët eventualisht kanë aplikuar nga data 01.01.2022 deri më sot,që do të thotë se nga data 01.01.2022 qytetarët nuk mund të subvencionohen.Ky projekt-vendim është diskriminues,sepse akoma virusi është aktiv dhe akoma ka të infektuar çdo ditë.Mendoj që, ju këtë vendim e keni përdorur për qëllimet tuaja politike të joshjes së qytetarëve.Kërkoj që të mbetet në fuqi vendimi për subvencionimin e qytetarëve të prekur me Kovid 19.

Shefket Kolgeci - kërkoj sqarime nga drejtoresha e shëndetësisë. Sa qytetarë kanë përfitu për infeksionin nga Kovid? Sa qytetarë kanë përfitu,pra ata që kanë përfundu me vdekje dhe pse po ndërprehet ky projekt-vendim? Unë propozoj që mos të ndërprehet ky vendim.

Aziz Bytyqi - nuk pajtohem me propozimin se ky vendim ka qenë me efekt politikë.Situata ka qenë e tillë,ku të gjithë jemi mobilize për ti ndihmu secilit që ka pas nevojë,pa asnjë dallim. Kërkesa për shfuqizim ka qenë edhe para zgjedhjeve,por nuk ka kalu.Unë kam një mospajtim dhe kërkoj të zbatohet nga dita e sotme,dhe jo nga 01.01.2022.

Festë Kabashi - në projekt-propozim e keni cekur që ndërprerja ka filluar nga data 1 janar. Duam të dime, çka ndodh me qytetarët e prekur të cilët janë lajmëruar pas dates 1 janar, dhe a janë subvencionuar apo jo. Personat që janë prekur deri më date 31.12.2021, ende nuk janë subvencionu, çka po ndodh me këto raste.

Besa Kuçi - përshëndet të pranishmit. Drejtorja e shëndetësisë e ka kategorinë në vlerë prej 70 mijë eurosh ku subvencionon qytetarët për sëmundje të papërballueshme, andaj nuk pajtohem me asambleistin e PDK-së që thotë që po ndërprehet subvencionimi. Ne po kërkojmë ndërprerjen e subvencionimit për Kovid 19. Kemi pranuar 1602 aplikacione dhe janë pranuar deri tani 1541. Raste të vdekjes kemi pas 100. Janë refuzuar 61 aplikacione. Në vitin 2021 janë subvencionuar me vlerë 73100 euro. Në pritje për pagesë të aplikacioneve që janë shqyrtu janë 101000 euro. Qytetarët kanë të drejtën të aplikojnë deri më date 28 shkurt 2022, në mënyrë që mos t'ju mbesim borgji. Ne si Komunë po e dëshmojmë që ju kemi dal në ndihmë qytetarëve, por këtë po e kërkojmë që mos me u ngarku buxheti, pasi vaksinat kanë dal.

Alban Berisha - ne i dimë shkaqet pse u dasht me ardh deri te ai vendim. Por kur të ndërprehet vendimi ,ne duhet ta dimë a kanë pushu ata shkakuar që e kanë pru atë vendim. Pse të ndërprehet kur shkaqet nuk kanë pushu. Shpresoj që është fundi i pandemisë dhe ta qojmë deri në fund. E thatë që nuk është politike, por ashtu po i bie.

Daradan Berisha - drejtoresha e ka keqkuptu propozimin e koleges, sepse ajo tha me bo kategorizimin e pesonave në bazë të gjendjes sociale, nese është e mundur. Nëse i referohemi pandemisë para dy viteve, ka qenë situatë e jashtëzakonshme dhe kjo shumë ndoshta jo e mjaftueshme por ka qenë një shpresë emocionale, dhe tash gjendja ka ndryshu, dhe po e kalojnë, mendoj që ky vendim duhet me u shfuqizua.

Bulëza Kuçi - në KPF ka qenë e njejtja pyetje se deri kur do të subvencionohen, dhe përgjigja ishte :deri në fund të dhjetorit dhe nga janari e tutje nuk do të subvencionohen. Ndërsa drejtoresha tha që edhe janari dhe shkurti. Cili verzion është i saktë?

Kryesuesi - do ta marrim verzionin e fundit.

Urim Suka - kam ankesa prej qytetarëve, të cilëve nuk iu kanë pranuar aplikacionet. Rasti i infektimit ka qenë në janar. Kjo është mirë të sqarohet për qytetarët.

Besa Kuçi - për rastin e qytetarit, ka edhe shumë qytetarë të tjera. Drejtoresha lexon vendimin e marrë nga Asambleja për Kovid 19. Ne në aplikacione e kërkojmë vërtetimin e institutit kombëtar të shëndetësisë ose vendimi i izolimit i lëshuar nga drejtorja e inspeksionit.

Urim Suka - drejtorja e inspeksionit nuk ia ka lëshuar vendimin, dhe unë mendoj që me arsyetimin që në janar dhe shkurt kena me shfuqizua.

Besa Kuçi - drejtorja e inspeksionit është e obliguar që të bëjë verifikimin e qytetarit nëse është në listë të institutit. Ajo më tej vazhdon me sqarime.

Shefket Kolgeci - kërkoj që mbledhjen e ardhshme ta kemi një pasqyrë, listen e ndihmave të atyre që kanë përfitu, ata që s'kan përfitu, dhe sa kanë mbetur pa marrë.

Besa Kuçi - ne si drejtori mund të japim numrin e saktë, por e kemi të ndaluar të publikojmë emrat dhe identitetin e personave që kanë qenë të infektuar.

Qëndrim Elshani - Asambleja ka bërë mirë që ka marrë një vendim të tillë për ti subvencionu qytetarët me Kovid. Ai që infektohet një here, dy e tre here, ai gjithmonë ka nevojë për tretman mjekësor, dhe duhet të subvencionohen njejtë. Unë pajtohem që variantet e Kovid po vin çdo here ma të lehta, por është e padrejtë me i kthyer ata që janë infektu prej 1 janarit deri sot e me i subvencionu ata që janë infektu deri më 31 dhjetor. Nëse merret ky vendim, duhet të merret prej 28 shkurtit 2022.

Festa Kabashi - kërkon sqarime lidhur me marrjen e vendimit të sotëm për datën dhe muajin e shfuqizimit të vendimit.

Kryesuesi - ne e kemi bo një propozim, mirëpo paska mundësi me i mbështet dhe e bëjmë prej sot, pra prej dates 28 shkurt 2022.

Qëndrim Elshani - çka i themi atyre që i kanë kthyer që kanë qenë të infektuar?

Kryesuesi - kanë të drejtë aplikimi.

Jehona Rrafshi - jep sqarime sa i përket mos marrjes së vendimit nga inspeksioni.

Flamur Bytyqi - marrja e këtij vendimi sot është shumë e padrejtë, duke e ditur që një familje ka humbur anëtarin e familjes nga virusi dhe tjetra ka shpenzuar mjete për shërim. Pastaj kohëve të fundit është edhe rritja e çmimeve. Mendoj që ky vendim të shtyhet deri më 31 dhjetor 2022.

Kryesuesi - janë dy propozime. Propozimi i AAK-së është që vendimi të shfuqizohet nga data 1 mars 2022, dhe propozimi i LDK-së deri më 31 dhjetor 2022.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin, që vendimi të shfuqizohet nga 1.03. 2022.

16 për, 11 kundër, 3 apstenime

Kryesuesi - hedh në votim propozimin,që vendimi të shfuqizohet nga data 31.12.2022.

11 për, 16 kundër, 3 apstenime

Miratohet propozimi i parë

Pika 11.

Kryesuesi - në materialin e dërguar e keni materialin për planin e prokurimit.

Pika 12. Pyetje pergjigje

Kryesuesi - hap debatin për pikën 11 dhe 12,pasi ka të bëjë me zyrën e prokurimit.

Selman Kolgeci - rreth 148 AK në Kosovë,rezulton që Komuna jonë është në mesin e 10 AK të cilat lëndët e prokurimit,në theks vlerësimin e tenderëve nuk po e bëjnë si duhet,meqë kemi lëndë të cilat në OSHP janë kthyer në rivlerësim e shumë tjera janë kthyer në favor të operatorit ekonomikë ankues.Dhe kjo na jep të kuptojmë se ky dikaster gjatë vitit 2021 dyshohet se disa procedura të prokurimit të zhvilluara vitin e kaluar,i ka shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale komunës sonë.Për të njejtin shqetësim kam pasur një reagim edhe vitin e kaluar.Gjatë vitit 2021,nga 167 procedura të prokurimit,janë refuzuar 71 operatorë ekonomikë,të cilët kanë ofertuar me çmime më të lira se sa fituesi i tenderit.Poashtu sipas publikimeve të Lëvizjes Fol rezulton që komuna jonë ka firmosur 18 kontarta pa publikimin e njoftimi.Vlen të theksohet që problematikë e prokurimit nuk është vetëm vlerësimi diskriminues e i anshëm,por dhe dyshime për kurdisje të denderëve për njerëzit e afërt me pushtetin,sikurse shqetësim tjetër është dhe mos përmbushja e kontratave të cilat me raste paraqiten si të përmbyllura.

Urim Suka - në këtë raport figuron që gjatë vitit 2021 keni nënshkru dy kontara për ndërtimin e rrugëve Amërllah Hoxha dhe Kolonja në fshatin Peqan.Këto rrugë janë shtru,por shqetësuese është fakti që në buxhetin e vitit 2022 ju prap e keni planifiku ndërtimin e këtyre dy rrugëve.Gjithëashtu në raportin e kontratave për vitin 2021 rezulton që keni nënshkru dy kontrata për rregullim e rrugëve Zef Tunaj e rrugë të tjera në fshatin Salllagrazhdë,dhe shqetësuese është se ju në plan të prokurimit për vitin 2022 prap e keni parapa rregullimin e këtyre rrugëve edhe pse janë të shtruara.Poashtu kjo praktikë vazhdon edhe në rrugën Kastërrc Breshanc.A mund të na thoni se si po planifikoni me hap procedura të tenderimit për rrugët që janë të shtruara.

Shqetësim tjetër është që ka kontrata të nënshkruara por punët nuk janë kryer ende.Ai tregon disa prej këtyre kontratave. Pas analizës së planit të prokurimit dhe raportin e kontratave për vitin 2021 shihet qartë se kemi keq planifikim të projekteve dhe keq menaxhim të kontratave.

Pika 13. Pyetje dhe përgjigje;

Selman Kolgeci - a është në fuqi akoma vendimi për fshatin Vraniq dhe Popolan,nëse është akoma,kërkoj nga ju Kryetar të ndani mjete nga cilido fond i mundshëm.Kërkoj mbështetjen e gjithë kolegëve për arsyen e mëposhtme: Gjatë bisedës me varrëmihësin në Vraniq kam kuptuar që kanë ndodhur disa herë raste,kur gjatë hapjes së varrit dalin eshtrat e kufomave të mëhershme.pyetjka tjetër i drejtohet Drejtorisë së Shëndetësisë.A jeni në dijeni që nuk ka oksigjen në QKMF dhe në QMF,dhe për çfarë arsye i kanë marrë bombolat nga të gjitha QMF dhe QKMF-të,dhe a jeni angazhuar që të siguroni oksigjen cilësor përmes kanaleve tjera?

Avni Bytyqi - në vitin 2015 apo 2016 është marrë vendimi në Kuvend për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Vraniq dhe Popolan dhe ai vendim është ende në fuqi por kohë pas kohe është formu komisioni për definimin e qështjes së lokacionit saktë dhe deri sot nuk është marrë asnjë veprim nga ai komision.

Kryesuesi - në atë kohë kam qenë asambleist dhe sa jam i informuar ka qenë një mosmarrëveshje mes dy fshatrave, Popolan dhe Vraniq dhe për atë arsye nuk është implementu.

Selman Kolgeci - nuk ka pas nevojë me u caktu asnjë komision,sepse ai lokacion e ka numrin e parcellës dhe numrin e parcellës mundemi me njerr në drejtorinë e pronës dhe katastroë.Kërkoj që të reagoni dhe të merrni hapa konkret.

Besa Kuçi - me rekomandim të inspektoriatit është rekomanduar që bocat e oksigjnit të tërheqen nga pikat,si në QKMF,si QMF dhe AMF për shkak se një boc prej tyre ka me shku për testim.Ne si drejtori kemi fillu një procedurë në zyrën e prokurimit ku kem bo kërkesë me anë të prokurimit të blejmë gaz medicinal. Nuk do të thotë që është jo cilësor dhe pritet që kompania testuese me dhanë ekspertizën.Ju informoj që në QKMF e kemi oksigjeno formuesin poashtu edhe në katër fshatra.

Selman Kolgeci – pse kanë vendos me i marr të gjitha bocat,dhe jo vetën një për mostër?Nese dikush na vdes,një bashkëvendas i joni,kush jep përgjegjësi për këtë peridhë që nuk mbulohet me oksigjen?

Besa Kuçi - nuk është e vërtetë që i kanë marrë të gjitha bocat.Unë e ceka që kemi oksigjen në QKMF dhe QMF.

Selman Kolgeci - bocat me oksigjen ,a i keni në disponueshmëri?

Besa Kuçi - jo.

Mimoza Bajraktari - përshëndet të pranishmit.Sa për sqarim,unë me sa kam informata, inspektoriati shëndetësor është duke bo testime nëpër të gjitha Komunitatet e oksigjenit dhe për furnizim me oksigjen duhet që kompania ta ketë patjetër liqencimin.

Selman Kolgeci - kush e merr përgjegjësinë që ne qytetarëve tanë iu kemi dhënë oksigjen të pa testum?

Aziz Bytyqi - edhe nëse e ke licencën,ti duhet të rilicencohesh,sepse licenca skadon.

Selman Kolgeci - është pak e rëndësishme licenca,por shqetësimi është se me çfarë gazi janë furnizu qytetarët.

Besa Kuçi - ne e kemi kërku prej kompanisë një qertifikatë,dhe janë organet kompetente që e mbulojnë këtë se a është valide apo jo.Nuk është shqetësim veq i yti por i të gjithë neve.E gjithë Kosova është furnizu me këtë oksigjen.

Selman Kolgeci - nuk e kam të qartë se si një institucion shëndetësor i beson një qertifikate.

Besa Kuçi - jemi furnizu nga ni kompani që e gjithë Kosova është furnizu.

Urim Suka - furnizimin me tekste e bën ministria e arsimit,por nga ana tjetër kemi informata që që ka pas munges të teksteve në disa shkolla, dhe ata janë detyru mi ble.A jeni në dijeni pse ka ndodh kjo dukuri.Pyetja tjetër,në drejtorinë e arsimit kanë mbet ni shumë e madhe e faturave të papagura nëpër shkolla.Pse ka ndodh kjo? Pyes Kryetarin,a je drejtor inspeksioni,a je Kryetar Komune?

Kryetari - ti e din mirë që drejtorat janë këshilltar.Janë me ni aprovim,nuk janë me konkurs dhe ajo është qështja ime.

Urim Suka - është edhe qështja ime sepse i përfaqësoj disa qytetarë.Mendoj që aty duhet me pas ni drejtor.

Flamur Bytyqi - sa është numri i kontaktave që zyra e prokurimit i ka në OSHP dhe sa është shuma e mjeteve financiare që Komuna e Suharekës përmes procedurave të prokurimit e ka dëmtu buxhetin e Komunës.

Kryetari - kërkon me shkrim dhe zyrtari i prokurimit i bje me shkrim.

Qëndrim Elshani - vi me kërkesë të lojtarëve që e shfrytëzojnë palestrën 13 Qershori,ku gjendja në zhveshtore është mjeruese.E di që janë nda mjete për ni aneks.Ish drejtori ka thënë që janë për zhveshtore.Kur do filloni me këtë projekt? kërkesë tjetër është e banorëve të lagjes 13 Qershori dhe shumë qytetarëve.Qasja e makinave në rrugën kryesore është tejet e vështirë dhe shumicën e rasteve rrezikohet komunikacioni.A e keni në plan me rregullu këtë problem dhe nëse po kur?

Kryetari - te pyetja e pare,është nda buxhet por nuk është leju zotimi i mjeteve dhe nuk kemi të drejtë me fillu me procedura.Në moment që bëhet zotimi, ne vazhdojmë me procedurat.Te rruga 13 Qershori,problem më i madh është të dielën, kur ka lojë Ballkani,por do të flasim me inspeksionin dhe ta rregullojmë.

Takimi përfundoi: 12:55

Procesmbajtësja:

Dafina Haziraj